



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 16/09/2022 Ref.: 1321/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 104-të, të mbajtur më 01.09.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohet** programi i studimit të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, për periudhën tri (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. *Mjekësi Paraklinike, PhD*, 180 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik.
- II. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- IV. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- V. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditim të programit të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS, Riakreditim	Shaip Krasniqi Hasime Qorraj-Bytyqi Valdete Topciu-Shufta Gazmend Kaçaniku Lidvana Spahiu

Me qëllim të vlerësimit të programit të studimit, AKA ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me këtë përbërje: Luc Hittinger, Joke Denekens dhe Jadranka Pelikan. Vizita është organizuar më: 22.06.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Standardet për Vlerësimin e Programeve të Doktoratës, ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Mjekësi Paraklinike, PhD, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush 36 standarde thelbësore dhe 14 standarde plotësuese të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 104 të mbajtur më 01.09.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit, të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. As. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

